



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1058, datë 25.11.2009

“Mbi përfundimin e procedimit administrativ për lidhjen e MI midis
Albtelecom Sh.a dhe Fjoers Online, US Partners.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | |
|----------------------|---------|
| 1. Z. Ilir Shehu | Kryetar |
| 2. Z. Afrim Tonuzi | Anëtar |
| 3. Znj. Edlira Kasaj | Anëtar |
| 4. Z. Ilir Zela | Anëtar |
| 5. Z. Jetmir Karini | Anëtar |

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e datës 25.11.2009, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike dhe Postare në Republikën e Shqipërisë”, me objekt: “Mbi përfundimin e procedimit administrativ për lidhjen e MI midis Albtelecom Sh.a dhe Fjoers Online, US Partners.”

mori në shqyrtim materialet shkresore të përbëra nga:

- Relacioni
- Projekt Vendimi
- Projekt-Urdherat

BAZA LIGJORE:

1. Neni 100 e në vijim i Ligjit Nr.8584 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” .(**Kodi i Procedurave**)
2. Neni 50 dhe neni 60 të ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr.9918**)

3. Pika 8 e Kreut VI, të rregullores “Për aksesin dhe interkoneksionin” (**Rregullorja**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 416, datë 7.12.2007 dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
4. pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (**Rregullorja e Brendëshme**), e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

Nga shqyrtimi i materialit të paraqitur, seancës dëgjimore të zhvilluar në datë.11.09.2009, fakteve dhe argumentave të dorëzuar nga palët, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E H E T se :

1. Operatoret Fjoers On Line dhe Davis Com me shkresë nr.prot.2636, date 30.06.2009 (ref AKEP) i është drejtuar AKEP dhe për dijeni Albtelecom, ngrejnë disa shqetësime për tarifimin nga Albtelecom të qarqeve E1 si pasojë e të cilës Fjoer Online nuk ka lidhur marrveshje Interkoneksionin me Albtelecom sh.a;
 - o Operatoret ushtrojnë aktivitete në zonën e Cerrikut, qarku Elbasan dhe sipas bllokskemes i takon Interkoneksion i ndermjetem (bashkevendosje në RSU)
 - o Në zbatim të Aneksit 4, Tarifat e shërbimeve, pika 1.3, pagesa për interkoneksionin e ndermjetem, pagesat për E1 do të llogariten sipas formulës:
 - PE =TE x {TrO/(TrO+TrA)}**, ku:
 - P = pagesa për cdo 2Mbps (E1)
 - T = tarifa për cdo 2Mbps (E1) (qarqet digital 2Mbps sipas tarifave në fuqi të Albtelecom)
 - E = “Mujore” për cdo 2Mbps (E1) ose “Instalimi” për cdo 2Mbps (E1) të ri që do të lidhet (që paguhet vetëm një herë)
 - TrO = trafiku mujor i zhvilluar nga operatori përfitues
 - TrA = trafiku mujor i zhvilluar nga Albtelecom
 Sipas tarifave të Albtelecom, tarifa për një qark dixhital 2Mb/s me qerë deri në 25km është 28.000 lek/muaj pa TVSH.
 - o Bazuar në zonat e interkoneksionit të Albtelecom, dhe faktin që Albtelecom zoteron Central Lokal RSU në Cerrik keta si operatore përfitues janë të detyruar të paguajnë cdo muaj tarifën 28 mijë lek/muaj.
 - o Albtelecom realizon të njëtin shërbim edhe me centralet lokale RSU dhe realizon tranzitimin në centralet Durrës dhe Tiranë pa asnjë detyrim tjetër shtesë, të E1. Ky veprim, sugjerojnë këta operatore, duhet të bëhet edhe në rastin e tyre, me qëllim ruajtjen e barazisë midis operatoreve përfitues, pasi edhe ata janë të interkonektuar me Durrësin dhe Tiranën në të njëjten mënyrë si dhe të tjerët.

- o Operatoret parashtrojne ne letren e tyre edhe disa faktore/rrethana te tjera :
 - ata kane fiiluar aktivitetin ne vitin 2003 ku sipas MI ekzistues, Albtelecom ishte i detyruar te sigurate Interkoneksion pa pagese mujore deri ne piken me te afert te Operatorit Rural. Bazuar ne keto kushte, jane bere dhe investimet ne vitin 2003 ne keto zona te largeta rurale dhe te varfera, nderkohe qe po tarifohen nga Albtelecom me kete tarife teper te rende dhe te paparishikuar ne aktivitetin tone ;
 - Kete tarife interkoneksioni, 28 mije leke /muaj vetem 4 operatoret e zones se Cerrikut duhet ta paguajne, dhe rendon shume ne kosto pasi te ardhurat tona mujore jane vetem rreth 50 mije lek/muaj ;
- o Operatoret kerkojne qe :
 - Ne zonat lokale te interkoneksionit nuk duhet bere dallim ne vartesi te centralit lokal (RSU apo jo RSU), pasi aktualisht te dy rastet nuk sherbejne per interkoneksion, dhe Albtelecom i realizon keto sherbime ne te dy rastet nepemjet centraleve ne Durres dhe Tirane.
 - Keto pagesa mujore duhet te vere si kushte per operatoret e rinj ne treg qe futen rishtazi dhe ti ndertojne plan bizneset e tyre mbi keto kosto
 - Kerkojme nderhyrjen e AKEP ne RIO ose ne MI te Albtelecom.

- 11 operatorë rurale (Selcom, Davis Com, US Partners,Fjoers Online,Enada Online, Sajet Rutel, Sabatel, Rutel, Albfruit, Fjoart, Elcom) me shkresën e dt. 12.07.2009 Nr.Prot (AKEP) 2823 dt.22.07.2009, parashtrojne sa me poshte vijon:

- o Draft MI e re e Albtelecom, pretenduar nga Albtelecom se eshte bazuar ne RIO, pervec tarifave te reja te terminimit dhe tranzitimit permban detyrime shtese per pagesa e qarqeve te interkoneksionit dhe mjeteve te transmetimit. Keto detyrime shtese jane ne kundërshtim me MI ekzistuese, te neshkruar ne janar 2007, sipas te ciles *pas mbarimit et afatit te MI palet kane te drejte dhe duhet et nenshkrjane nje MI te re me te njetat kushte ose duke pranuar ndryshiem ne varesi te rrethanave te tregut dhe kuadrit rregullator ne zbatim te ligjit*. Keto detyrime shtese nuk argumentojne ndonje rrethane te re te tregut apo kudri rregullator te ndryshem per kete ceshtje.
- o Tarifat e MI (terminim dhe tranzitim) nekuptojne qe keto tarifa perfshijen koston e plote te sherbimit me te gjithë elementet e infrastruktures dhe facilitetet e perdoruara deri ne piken e interkoneksionit te percaktuar tashme bashkarisht per operatoret rurale ekzistues qe nga viti 2001. Pikat e interkoneksionit kane qene sa me afer operatorit rural ne cdo zone e Shqiperise dhe detyrimi i opereve rurale, pervec tarifave te terminimit dh e tranzitimit, ka qene vetem nje tarife per E1 me vlere 20.000 lek ne vit, dhe kjo qe nga viti 2001 e deri tani.
- o Draft MI krijon disa efekte negative si:

- Detyrimet shtese diferencojen ruralet midis tyre: vetem OR qe jane te lidhur ne RSU duhet te paguajne keto detyrime ndersa OR te tjere jo.
- Tarifat shtese nuk paraqesin apo justifikojne ndryshime te imponuara nga tregu apo kuadri rregullator, duke ekspozuar OR ndaj nje klime biznesi te paqendrueshme
- Tarifat e detyrimeve shtese kane vlere te larta te pamiratuara nga AKEP ne reference te nje kostoje te argumentuar e te pranuar si dhe tarifat e tjera. Nga Analiza keto tarifa arrijne vleren e nje trafiku tranzitues dhe terminues te nje operatori, dhe jane te paargumentuar:
 - Tarifa 28000 leke ne muaj pa TVSH eshte 403.200 leke ne vit apo 3100 euro ne vit me TVSH, nese raporti i trafikut te dyanshem eshte 1.
 - Tarifa e fibres optike parashikohet 24000 lek/muaj (me TVSH) per 3 km e para dhe 2200 per cdo km shtese, apo 288000 leke (2215 euro) per 3 km e para +22- euro per cdo km shtese
 - Tarifa e linjes se bakrit eshte 4000 lek per cdo km der ne piken e interkoneksionit me operatorin perfitues
 - Ne draft MI nuk parashikohet tarife ekuivalente per linjen e bakrit nga POI deri ne centralin e OR, linj e investuar nga ky i fundit
- o Ne perfundim OR kerkojne:
 - AKEP te nderhyje prane Albtelecom zgjidhjen e kesaj mosmarreveshje duke qartesuar se ne RIO nuk ka anje qendrim detyrues qe Albtelecom te mos realizoje ne centralet RSU sherbimin e deritanishem per interkoneksionin tranzit drejt centralit Tranzit Durres per OR aktuale, cka do te anulloje keto pagesa te shtese dhe te vazhdohet sipas tarifave te MI 2007
 - Te ndaloje aplikimin e tarifave te paraqitur nga Albtelecom ne draft MI e re te tarifave te E!, FO dhe linjen e bakrit) dei kur kostot efektive te tyre te verifikohen dhe miratohen nga AKEP sic eshte vepruar me tarifat e tjera.
 - Nese AKEP do te vendose perfshirjen e tarifave te permendura ne masen e caktuar prej saj, duhet qe njekohesht te kushtezoje Albtelecom qe keto lloj tarifimesh ti negocioje meata operatore perfitues qe hyjne ne treg rishtazi
- Albtelecom ka dhënë **shpjegimet** si më poshtë:
 - o Albtelecom ka lidhur MI me te gjithë OR, pervecse me Fjoers online per kontestim dhe me US Partners dhe Iva Elektronik per pamundësi ardhjeje per nenshkrim;
 - o Me Fjoers Online, edhe pas letres se ketij operatori drejtuar AKEP dhe Albtelecom (30.06.2009), nga ana e Albtelecom jane bere te gjitha perpjekjet per ti shpjeguar dhe sqaruara skatesine dhe trajtimin me dershmeri, objektivitete dhe buon sens per rastin e interkoneksionit te ndrmjetem per perdorimin e linjave 2mbps, FO, linja bakri duke shpjeguar se RIO nuk refernce qe RSU te te trajtohen

si pika lokale, rajonale apo kombetare interkoneksioni, prandaj Albtelecom ka ofruar me bunsens te plote trajtimi e ketyre rasteve sipas formules e cila eshte bere e njohur.

- o Per aplikimin e Formules, Albtelecom ka dhenë informacion dhe sqarime te gjithe operatoreve, si edhe AKEP me shkresat nr.3998, date 27.05.2009, nr.4044/1, date 8.06.2009.
- o Fjoers online ka pranuar ne terësi MI dhe nderkohe se fundmi me sa na prezantohet nga ana e tij, konteston nenshkrimin e MI per faktin se ka parqitur nje leter ne AKEP per ceshtjen e lidhjes ne ambientet e RSU ne Cerrik dhe nuk mund ta nenshkruaje MI para se AKEP et organizoje nje takim apo marre nje pergjigje nga AKEP per letren e tij.
- o Albtelbetelcom kerkon sa me shpejt te jete e mundur nje prononcim nga AKEP per ceshtje e ngritura me Fjoers online. Albtelecom eshte i gatsehm te marre pjese ne nje takim urgjent bashke me Fjoers, me qellim trajtimin dhe arritjen e nje mirekuptimi te plote për nënshkrimin e MI.

2. Në zbatim të nenit 50 të Ligjit 9918 dhe nenit 66 të Kodit të Procedurave Administrative, me vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 945 datë 28.09.2009 , filloi procedimi administrativ për shqyrtimin e pretendimeve të palëve për moslidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit.

Palët në procedim (Albtelecom sh.a Fjoers Online, US Partners) si dhe palët e

interesuara (Davis Com dhe Selcom) paraqitën argumentat e zhvillimit te

negociatave me shkresat e mëposhtëme:

- Shkresa Operoret Fjoers On Line dhe Davis Com me shkrese nr.prot.2636, date 30.06.2009 (ref AKEP)
- Shkresa e Albtelecom me Nr.prot.5517, date 17.07.2009
- Shkresat e Albtelecom me Nr.3998, date 27.05.2009, nr.4044/1, date 8.06.2009.
- Shkresae e 11 operatorëve rurale Nr.Prot (AKEP) 2823 datë 12.07.2009
- Shkresa e Albtelecom Nr.prot 5629/1, date 29.07.2009
- Shkresa Opearatorit Fjoers Online Nr.Prot (AKEP) 3568 datë 14.09.2009,
- Shkresa Operatorit US Partners me Nr.Prot Ak-09/09 datë 07.09.2009.
- Shkresa Albtelecom Nr. 6958 datë 01.20.2009 “dërgim informimi”
- Shkresa e operatorit Davis Com Nr.Prot (AKEP) 3365/10 datë 03.09.2009.
- Shkresa e operatorit Selcom Nr. 61/0709 datë 07.09.2009.

2. Pika për të cilat Altelecom dhe Fjoers Online, US Partners nuk kanë arritur marrëveshje.

Pagesat per qarqet e inerkoneksionit apo mjetet e transmetimit

3. Palët në seancën dëgjimore të zhvilluar në AKEP në datën 11.09.2009 pretenduan se:
 - Fjoers Online dhe US Partners : Në MI e paraqitur nga Altelecom janë aplikuar detyrime shtese per qarqet e interkoneksionit E1 dhe mjeteve te transmetimit (Linje bakri dhe fiber optike). Rigrupimi i centralit te Cerrik nga Altelecom ne central RSU, vedos nje detyrim shtese per qarkun e interkoneksionit E1 e cila i shtohet vleres reale te trafikut terminues dhe tranzitues dhe rrit tarifat e tyre ne 70-80 %. Operoret rurale janë konsieruar si komplementar te Albletecom me qëllim per te shtrire dhe zgjeruar sherbimin telefonik fiks ne te zonat e largeta ku Altelecom nuk mund te shtrihet. Prandaj tendenca e Altelecom per njësimin e operatorëve rurale me subjektet te tjera qe operojne ne qytete s’është e drejtë. Gjithashtu me këto detyrime shtesë ngarkohen vetëm një pjesë e vogël e operatorëve rurale dhe me vendodhje ne zona te largeta dhe të varfra. Nëse nga Altelecom do të vendosen rregulla të reja duhet ti verë si kushte të reja ne nje kohë të re për operatorë të rinj.
 - Altelecom : MI e ofruar ketyre dy operatoreve është me të njëjtat kushte sic janë lidhur dhe me te gjithë operoret e tjere. Altelecom ju ofron ketyre operatoreve interkoneksion te ndërmjetëm pra interkoneksion ne ambjentet e ofruesit perfitues. Per kete lloj interkoneksioni Operoret Alternativ perdorin facilitetet e Altelecom, nivel 2Mbps (E1) apo FO , mjete transmetimi) per te ardhur ne ambjentet e centrave sic percaktuar edhe ne RIO. Sipas dispozitave te miratuar ne RIO per kete lloj interkoneksioni per fasilitetet e Altelecom për të perdorur likun e interkoneksionit duhen kryer pagesa. Altelecom i ka ofruar një formulë që lidh tarifën e Altelecom për E1 në raport me trafikun e shkëmbyer mes palëve. Po

kështu është ofruar edhe për linjat e bakrit një formulë që është e lidhur me trafikun e shkëmbyer mes palëve.

4. Nga dëgjimi i palëve në seancën dëgjimore, u vërejt se Operatori Fjoers Online me veprimtari në Cërrik ka lidhur interkoneksionin në Elbasan, thirrjet e këtij operatori drejt abonentëve të Albtelecom Elbasan tarifohen si thirrje lokale, ndërsa thirrjet e po këtij operatori drejt abonentëve Albtelecom Elbasan tarifohen si thirrje rajonale;
5. Nga informacioni i paraqitur nga Albtelecom me shkresë Nr. 6958 datë 29.09.2009, rezulton se:

25 operatore kanë marrë në përdorim mjete transmetimi nga Albtelecom, në formën e linjave E1 2 Mbit/s, Fiber optike apo linja bakri, me qëllim lidhjen e pikës së interkoneksionit të Albtelecom me pikën e prezencës së operatorit tjetër si më poshtë:

- 8 Fiber Optike (4-13 km)
- 18 E1
- 16 kopje bakri

Operatori Fjoers Online ka marrë nga Albtelecom 1 Kopje bakri për lidhjen e centralit të tij me RSA Cërrik të Albtelecom, 1 E1 për lidhjen e RSU Cërrik me centralin rajonal Elbasan, si edhe një Fiber Optike 13km në Tiranë.

ATEHERE:

Këshilli Drejtues, në zbatim të nenit 60 Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike” dhe nenit 100 të “Kodit të Procedurave Administrative” më shqyrtim të fakteve dhe dëgjimit të pretendimeve në seancën dëgjimore konstaton se:

1. Albtelecom në përputhje me RIO-n e miratuar nga AKEP me Vendimin Nr. 630 dt.10.02.2009, i ka paraqitur të gjithë operatorëve Marrëveshje Interkoneksioni, midis tyre edhe operatorit Fjoers Online. Ky operator e ushtron veprimtarinë e tij në Cërrik duke qënë se Albtelecom ka RSU në Cërrik atëherë lidhja e këtij operatori bëhet në centralin rajonal Elbasan. Për të interkonektuar me centralin e rajonal Elbasan përdorin interkoneksion të ndërmjetëm. Albtelecom ka ofruar qark interkoneksionit E1 dhe një linjë bakri. Në zbatim të RIO për interkoneksionin e ndërmjetëm Albtelecom (Lidhja 2 e Albtelecom tregon interkoneksionin e ndërmjetëm të realizuar me 25 operatore) ofron shërbimet e qarqeve të interkoneksionit në bazë të negociatave me operatorin përfitues sipas mundësive që ka. Tarifimi dhe koha e realizimit vendosen në negociatat midis Albtelecom dhe Operatorit përfitues. Albtelecom i ka ofruar një formulë që lidh tarifën e Albtelecom për E1 në raport me trafikun e shkëmbyer mes palëve. Po kështu është

ofruar edhe për linjat e bakrit një formulë që është e lidhur me trafikun e shkëmbyer mes palëve. Aplikimi i kësaj formulë është bërë për të gjithë operatorët me interkoneksin të ndërmjetëm . Një përlogaritje e tillë është bërë nga ana e Albtelecom dhe paraqitur pranë AKEP në informacioni Nr. 6958 datë 29.09.2009.

2. Operatori US Partners është lidhur me interkoneksion të ndërmjetëm në centralin lokal të Pogradecit, Lidhja është realizuar me Fibren optike të Albtelecom 8.2 km, aplikimi i formulës është bërë ashtu siç dhe për të gjithë operatorët e tjerë duke marrë si koeficient edhe trafikun e shkëmbyer mes palëve.

Pra për shërbimet për interkoneksionin e rrjeteve publike telefonike, vërehet se Albtelecom ka ofruar të njëjtën pagesë dhe formulë përlogaritje për të gjithë operatorët pra e ka kryer në baza jodikriminuese.

3. Ofrimi nga Albtelecom i qarqeve transmetuese për lidhjen e pikave lokale dhe rajonale të interkoneksionit është në përputhje me RIO-n e miratuar nga AKEP, pasi konsiderohet interkoneksion i ndërmjetëm:

Per interkoneksionin në anën e operatorit përfitues dhe interkoneksioni i ndërmjetëm Albtelecom ofron shërbimet e qarqeve të interkoneksionit në bazë të negociatave me operatorin përfitues dhe sipas mundësive që ka. Tarifimi dhe koha e realizimit vendosen në negociatë midis Albtelecom dhe operatorit përfitues, dhe ky informacion i raportohet AKEP së bashku me marrëveshjen e Interkoneksionit të lidhur midis palëve.

4. Përdorimi nga Albtelecom i një formulë përdorimi sipas trafikut të shkëmbyer, për kapacitetet transmetuese të dhëna në përdorim për interkoneksionin e ndërmjetëm, është i drejtë mëqenëse këto qarqe janë për përdorim të përbashkët. Nga të dhënat rezultojnë se shumë prej operatorëve kanë koeficient përdorimi (shfrytëzimi) të ulët. Fjorës online për përdorimin e kapaciteteve në Elbasan ka një koeficient shfrytëzimi prej 0.28, për muajin Gusht 2009, duke rezultuar në pagesë më të ulët për kapacitetet prej 10 mijë leke, ndërsa vlera e detyrimit për Albtelecom për trafikun e përcjellë në këtë pikë interkoneksioni është 53 mijë leke. Ndërsa për interkonektimin në Tiranë Fjorës online ka një koeficient shfrytëzimit të Fibres Optike prej 0.99, për muajin Gusht 2009, duke rezultuar në pagesë më të ulët për kapacitetet prej 40 mijë leke, ndërsa vlera e detyrimit për Albtelecom për trafikun e përcjellë në këtë pikë interkoneksioni është 285 mijë leke. Këto vlera të detyrimeve për Albtelecom tregojnë qartë se xhiro më të ulët dhe Fjorës online është shumë më e madhe se vlera e deklaruar në AKEP gjatë takimeve prej 50 mijë leke.
5. Tarifat e aplikuar nga Albtelecom për qarqet 2Mbit/s janë të njëjta me tarifat me pakicë të linjave me qerë, dhe kjo praktikë mund të

jete ne kundertshtim me aplikimin e tarifave me shumice me te vogla se tarifate me pakice. Megjithate, perdorimi i formulese se shfrytezimit, per te llogaritur detyrimet, zvogelon ndjeshem detyrimet e operatoreve te vegjel. Gjithashtu, AKEP ne dokumentin "Analize e Tregut te Linjave me Qera: Tregu me pakice i minimumit te linjave me qera, tregjet me shumice te segmenteve terminuese dhe trunk te linjave me qera : Konsultim Publik", miratuar me VKD nr. 1030, date 17.11.2009, ka evidentuar se tarifate e linjave me qera 2 Mbit/s me pakice jane ndjeshem nen-mesataren e vendeve te BE, duke propozuar rritjen e ketyre tarifave me pakice si dhe aplikimin e nje zbritjeje 20% per ofrimin e tyre per operatoren, duke rezultuar ne rritje nga 203 Euro/muaj ne 470 Euro/muaj per qarqet 2Mbit/s me distance deri ne 2Km, dhe me te larta per distancat e tjera. Ne kete dokument per konsultim publik, AKEP ka mbajtur qendrimin e meposhtem:

Per linjat me qera me pakice dhe me shumice (perfshire qarqet e pjesshme te linjave me qera te dhena operatoreve per interkoneksion) te cilat kane tarifa me te uleta se mesatarja e vendeve te BE, AKEP gjykon qe keto tarifa te mos ndryshojne deri ne justifikimin e kostos se tyre nepermjet modelit BULRAIC, per klientet me te cilet Albtelecom ka lidhur tashme nje kontrate.

Ne kete menyre, AKEP gjykon se perdorimi i tarifave aktuale per kapacitetet transmetuese te dhena nga Albtelecom per interkoneksion, eshte i arsyeshem dhe te mos ndryshoje deri ne daljen me vendim te AKEP per rregullimin e tarifave te kapaciteteve transmetuese me qera, me pakice dhe me shumice, bazuar ne analizen e tregut te linjave me qera dhe rezultatet e modelit te kostove BULRAIC.

6. Sipas skemave te interkoneksionit te Fjoers Online dhe Albtelecom, rezulton se ne Elbasan, Fjoers On line eshte i lidhur ne centralin RSU te Cerrikut, si dhe ne centralin rajonal te Elbasanit, duke perdorur dhe paguar kapacitetet transmetuese te Albtelecom. Bazuar ne parashikimet e RIO-s te Albtelecom, per perkufizimet e segmenteve te terminimit si edhe percaktimit se:

12 centralet rajonale te listuar ne Aneks 7, sherbejne edhe per interkoneksion ne nivel lokal per zonen urbane te qytetit perkates.

Fjoers On-line, per interkonektimin ne Elbasan dhe Cerrik duhet te paguaje Albtelecom:

- a. tarife terminimi lokal per terminimin e thirrjeve qe dorezohen ne piken lokale te interkoneksionit ne Cerrik dhe terminohen tek perdoruesit e Albtelecom, serite numerike te te cileve i perkasin RSU Cerrik;
- b. tarife terminimi lokal per terminimin e thirrjeve qe dorezohen ne piken rajonale te interkoneksionit ne Elbasan dhe terminohen tek perdoruesit e Albtelecom, serite numerike te te cileve i perkasin Centralit Lokal Elbasan;
- c. tarife terminimi njefish per terminimin e thirrjeve qe dorezohen ne piken rajonale te interkoneksionit ne Elbasan dhe terminohen tek perdoruesit e Albtelecom, serite numerike

te te cileve i perkasin centraleve lokale te lidhur me centralin rajonal Elbasan.

- d. tarife terminimi dyfish per terminimin e thirrjeve qe dorezohen ne piken rajonale te interkoneksionit ne Elbasan dhe terminohen tek perdoruesit e Albtelecom, serite numerike te te cileve i perkasin centraleve lokale te lidhur me nje central rajonal te ndryshem nga centrali rajonal Elbasan.

Per sa me siper, Keshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I :

1. Të urdhërojë, lidhjen e marrëveshjeve të Interkoneksionit brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të Urdhërave për sipërmarrësit:
 - Albtelecom sh.a dhe Fjoers Online
 - Albtelecom sh.a dhe US Partners.
2. Marrëveshjet e interkoneksionit të lidhet sipas RIO-s se Albtelecom sh.a miratuar me VKD Nr. 630 datë 10.02.2009, si edhe duke perfshire:
 - 2.1. Albtelecom për interkoneksionin e ndërmjetëm të ofroje shërbimin e qarqeve të interkoneksionit me tarifimin dhe formulën e zbatuar me të gjithë operatorët e tjerë, si vijon:

Për lidhjet në nivel 2 Mbps (E1)

$P_E = T_E \times \{TrO / (TrO + TrA)\}$, ku:

P = pagesa per cdo 2Mbps (E1)

T = tarifa per cdo 2Mbps (E1) (qarqet digital 2Mbps sipas tarifave ne fuqi te Albtelecom)

E = "Mujore" per cdo 2Mbps (E1) ose "Instalimi" per cdo 2Mbps (E1) te

ri qe do te lidhet (qe paguhet vetem nje here)

TrO = trafiku mujor i zhvilluar nga operatori perfitues

TrA = trafiku mujor i zhvilluar nga Albtelecom

Tarifa per nje qark dixhital 2Mb/s me qera deri ne 25km eshte 28.000 lek/muaj pa TVSH.

Për lidhjet me mjete fizike (FO, linja bakri)

$P_M = T_M \times \{TrO / (TrO + TrA)\}$, ku:

P = pagesa për mjetin fizik të tranmetimit (çift fiber FO ose linja bakri)

T = Tarifa për mjetin fizik të tranmetimit (çift fiber FO ose linja bakri

sipas tarifave në fuqi të albtelecom)

M = Mujore për cdo mjet transmetimi

Ose

Instalim për cdo mjet tranmetimi qe do te instlohet (qe pagueht

vetem nje here)

TrO = trafiku mujor i zhvilluar nga operatori perfitues

TrA = trafiku mujor i zhvilluar nga Albtelecom

Tarifa e fibres optike eshte 24000 lek/muaj (me TVSH) per 3 km e para dhe 2200 per cdo km shtese, apo 288000 leke (2215 euro) per 3 km e para +22- euro per cdo km shtese

Tarifa e linjes se bakrit eshte 4000 lek per cdo km deri ne piken e interkoneksionit me operatorin perfitues.

2.2. Fjoers On-line, per interkonektimin me Albtelecom ne Elbasan dhe Cerrik duhet te paguaje Albtelecom:: .

a. tarife terminimi lokal per terminimin e thirrjeve qe dorezohen ne piken lokale te interkoneksionit ne Cerrik dhe terminohen tek perdoruesit e Albtelecom, serite numerike te te cileve i perkasin RSU Cerrik;

b. tarife terminimi lokal per terminimin e thirrjeve qe dorezohen ne piken rajonale te interkoneksionit ne Elbasan dhe terminohen tek perdoruesit e Albtelecom, serite numerike te te cileve i perkasin Centralit Lokal Elbasan;

c. tarife terminimi njefish per terminimin e thirrjeve qe dorezohen ne piken rajonale te interkoneksionit ne Elbasan dhe terminohen tek perdoruesit e Albtelecom, serite numerike te te cileve i perkasin centraleve lokale te lidhur me centralin rajonal Elbasan.

d. tarife terminimi dyfish per terminimin e thirrjeve qe dorezohen ne piken rajonale te interkoneksionit ne Elbasan dhe terminohen tek perdoruesit e Albtelecom, serite numerike te te cileve i perkasin centraleve lokale te lidhur me nje central rajonal te ndryshem nga centrali rajonal Elbasan.

3. Urdhërat për lidhjen e Marreveshjeve të Interkoneksionit të hyjnë në fuqi ditën e njoftimeve të tyre.
4. Palët të depozitojnë pranë AKEP Marrveshjet e Interkoneksionit të lidhura në vijim të urdhrave të dale në zbatim të këtij vendimi.
5. Të njoftohen për këtë vendim edhe 9 operatorët ruralë si dhe cdo palët tjetër e interesuar.
6. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

Ilir SHEHU

Anëtarë të Këshillit Drejtues:

- 1. Afrim TONUZI**
- 2. Edlira KASAJ**
- 3. Ilir ZELA**
- 4. Jetmir KARINI**